



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

NJOFTIM

PËR POZICION TË LIRË PUNE

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

PROCEDURA E PRANIMIT NË KATEGORINË E NIVELIT TË LARTË DREJTUES.

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr.152 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të Kreut VIII të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014 Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së” i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, njofton se:

Në Administratën e KQZ-së ka 1(një) vend të lirë pune në pozicionin, Sekretar i Përgjithshëm në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kategoria e pagës I-2.

Afati për dorëzimin e dokumentave:

30.09.2024

Me vendimin nr. 170 prot., datë 30.08.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve procedura e plotësimit të vendit të lirë për pozicionin Sekretar i Përgjithshëm në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është i hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil që plotësojnë kushtet dhe kërkesat specifike për pranim në këtë kategori.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

1. Përgjigjet për mbikëqyrjen dhe koordinimin e punës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Ka përgjegjësinë kryesore të menaxhimit dhe koordinimit të punës dhe politikave ndërmjet drejtorive për zbatimin në mënyrë efçente të vendimeve të KQZ, urdhrave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve apo përdorimin efçent të të gjitha burimeve financiare njerëzore për arritjen e rezultateve të përcaktuara.
3. Mbikëqyr procesin e përgatitjes së projektbuxhetit dhe kontrollon zbatimin e të gjithë treguesve të tij, pasi miratohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
4. Nxjerr urdhra në ushtrim të kompetencave ligjore dhe miraton detyrat dhe rregullat e brendshme të organizimit të strukturave të administratës së KQZ, në përputhje me strukturën e KQZ.
5. Ndjek zbatimin e rregullave të etikës të nëpunësve dhe punonjësve të shërbimeve të KQZ, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të Administratës së tij.
6. Miraton përshkrimin dhe kriteret e veçanta për çdo pozicion pune të KQZ.
7. Koordinon nëpërmjet shërbimeve të burimeve njerëzore, punën për kryerjen e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, të nëpunësve civilë, si dhe të shpërblimit të tyre, bazuar në këtë vlerësim.
8. Koordinon punën për përgatitjen e raportit vjetor të veprimtarisë së KQZ dhe ia paraqet atë për miratim Komisionerit.

9. Ndjek procedurat e duhura financiare dhe respekton procedurat e përshtatshme të kontabilitetit, me qëllim që të mbrohen dhe të menaxhohen si duhet fondet publike.
10. Përcakton rregullat për regjimin e hyrjeve dhe të daljeve të nëpunësve të KQZ, si dhe të mjeteve në dispozicion të tyre.
11. Ushtron çdo kompetencë tjetër, që i jepet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Administratës.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ose të një kategorie më të ulët, nivel i mesëm drejtues);
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c) të ketë, të paktën, vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë;

1. Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike, ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat Juridike ose Ekonomike.
2. Të disponojë dëshmi/certifikatë dhe të flasë e të shkruajë një gjuhë të BE, avantazh anglisht.

Për kandidatët nëpunës civil, të nivelit të mesëm drejtues:

- Të kenë 2 (dy) vjet eksperiencë pune, si nëpunës civil në nivelin e mesëm drejtues ose në pozicione të barazvlefshme.

Për kandidatët nëpunës civil, nivelit të lartë drejtues:

- Të kenë 1 (një) vjet eksperiencë pune, si nëpunës civil në nivelin e lartë drejtues ose në pozicione të barazvlefshme.

Për kandidatët, nga jashtë shërbimit civil:

- Për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë të kenë 5 (pesë) vite përvojë pune në profesion në fushën Ekonomike ose Juridike.

Kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

1. Njohuri mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Njohuri mbi ligjin nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë: i ndryshuar;
3. Njohuri mbi ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
4. Njohuri mbi ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”;
5. Njohuri mbi ligjin nr. 90/2012, “Për administrimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
6. Njohuri mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar ;
7. Njohuri mbi ligjin nr. 913, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

8. Njohuri mbi ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
9. Njohuri mbi ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
10. Njohuri mbi vendimin nr. 21, datë 26.02.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të KQZ-së, dokumentet e dosjes së tij personale:

Të gjitha grupet e kandidatëve si më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Një kopje të jetëshkrimit (C.V);
3. Fotokopje e diplomës nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
4. Fotokopje e listës së notave nëse ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çertifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
10. Fotokopje e letërnjoftimit (ID-së);
11. Aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil të nivelit të mesëm drejtues (për kandidatët në shërbimin civil);
12. Formularin e vlerësimit të punës për periudhën Janar – Qershor për vitin 2024 (për kandidatët në shërbimin civil);
13. Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda datës **30.09.2024**.

Në datën **09.10.2024** brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e afatit të fundit të dorëzimit të dokumentacionit do të shpallet lista e aplikuesve që plotësojnë kriteret specifike për t’iu nënshtuar konkursit, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KQZ-së dhe në stendën e informimit të publikut.

Kandidatët e skualifikuar do të njoftohen individualisht nga njesia përgjegjëse për shkaqet e moskualifikimit, në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak.

Kandidatët e pakualifikuar paraqesin ankesat me shkrim pranë njesisë përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendrike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendrike nga data e depozitimit të saj.

TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA E STRUKTURUAR ME GOJË DO TË ZHVILLOHET NË KQZ NË DATËN 31.10.2024 ORA 10-00

Mënyra e vlerësimit të Kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit**.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që përfshin në vlerësimin e arsimit, ekperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, sidhe vlerësimet e arritjeve vjetore, 10 pikë;

Testim me shkrim, 40 pikë;

Intervistën e strukturuar me gojë, 50 pikë.

Pas zhvillimit të testimit me shkrim kandidatët do të njoftohen individualisht nëpërmjet njësisë përgjegjëse në lidhje me datën dhe orën e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë.

KKP-ja shpall listën e kandidatëve fitues të renditur me mbi 70 pikë dhe renditjen e tyre duke filluar nga ai me më shumë pikë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk janë shpallur fitues do të njoftohen nga njësia përgjegjëse.

Vendimi merret jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga përfundimi i procedurës së konkurrimit.

Lista e fituesve e përbërë nga kandidatët që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë dhe brenda numrit të pozicioneve për të cilat konkurrohet, do të shpallet në faqen e internetit www.kqz.gov.al, dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten me shkrim në KPP, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

Për një informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në adresën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr.4, Tiranë si dhe të konsultoni faqen zyrtare në internet www.kqz.gov.al.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse